

MENDIM PAKICE

Unë, anëtar i trupit gjykues Roland Ilia, kam votuar kundër vendimit të marrë nga shumica për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Naim Tota, me detyrë prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Në mbështetje të qëndrimit kundër, parashtroj në vijim arsytet mbi të cilat duhej që në përfundim të hetimit administrativ ndaj subjektit të rivlerësimit të ishte dhënë masa e shkarkimit nga detyra për arsytet e mëposhtme:

Lidhur me kontrollin e pasurisë

1. Apartament banimi në rrugën “*”, Tiranë**

1.1 Në lidhje me pasurinë objekt vlerësimi – apartament banimi të ndodhur në rrugën “***”, Tiranë, në përfundim të hetimit u konstatua se: (i) porositësi/blerësi fillestar i kësaj pasurie nuk e ka disponuar dhe përdorur asnjëherë atë; (ii) subjekti dhe familja e tij e kanë përdorur pa kundërshpërblim këtë pasuri për një periudhë të pandërprerë prej rreth 12 vjetësh; (iii) në kontratën e cedimit të të drejtave, datë 16.3.2016, është përcaktuar se ceduesi deklaroi se pagesat e këtyre 3 kësteve në vlerë totale 50,000 USD, që i ka likuiduar shoqërisë sipërmarrëse, i janë dhënë nga përfituesi (subjekti i rivlerësimit); (iv) subjekti deklaroi se e ka përdorur pa kundërshpërblim këtë pasuri, ndërkohë, nga ana tjetër, në vitin 2008 i ka dhënë hua me interes shtetasit T.H, i cili i kishte lënë në përdorim këtë pasuri; (v) në kontratën e cedimit të të drejtave përcaktohet i njëjti çmim i paguar nga subjekti (si përfitues) në vitin 2016 më atë të cilin kishte paguar ceduesi në vitin 2003; (vi) pamundësinë financiare të ceduesit për blerjen e kësaj pasurie në vitin 2003.

1.2 Për këto gjetje, Komisioni ngriti dyshime të arsyeshme se kemi të bëjmë me pasuri të fshehur, të porositur dhe paguar nga subjekti i rivlerësimit që në vitin 2003, me qëllim përdorimin, disponimin dhe gëzimin e plotë nga ana e tij, por se kontrata e porosisë është lidhur në emër të z. T.H (person tjetër i lidhur), në dukje me qëllim shmangien e kontrollit dhe verifikimin e ligjshmërisë së burimeve, të cilat kanë shërbyer për pagesën/pagesat e kryer/a për likuidimin e çmimit të blerjes të saj.

1.3 Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, me dërgimin e rezultateve të hetimit Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit, duke i kërkuar të paraqesë argumentet/shpjegimet përfundimtare, si edhe të depozitojë prova të reja të mundshme mbi konstatimin e mësipërm.

1.4 Komisioni verifikoi dhe analizoi mundësitë financiare dhe të ardhurat e përfituara nga personi tjetër i lidhur, shtetasi T.H dhe/apo familjarët e tij, përpara kryerjes së pagesave për likuidimin e çmimit të plotë për apartamentin objekt vlerësimi, kreu analizën e treguesve financiare – me rezervë, nga ku rezultoi se personi i lidhur nuk ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht likuidimin e çmimit të blerjes së pasurisë objekt vlerësimi – apartamentit në Tiranë, likuiduar plotësisht deri në datën 29.12.2003.

i. Lidhur me faktin e mospërdorimit të kësaj pasurie nga blerësi fillestar, subjekti deklaroi se blerja e kësaj pasurie është bërë si investim nga ana e personit tjetër të lidhur

z. T. H dhe jo për të banuar, për sa kohë ai ka pasur të ndërtuar/në ndërtim e sipër një pasuri të paluajtshme të llojit “banesë” në zonën e ***, Tiranë, ku edhe ka banuar dhe banon aktualisht. Nga ana e shumicës së trupit gjykues nuk është marrë në analizë dhe vlerësim ky fakt, si dhe shpenzimet e kryera nga personi tjetër i lidhur këtë periudhë për këtë pasuri të paluajtshme. Përdorimi nga subjekti i kësaj pasurie pa kundërshpërblim nga momenti i krijimit të saj deri në momentin e cedimit (2004 – 2016) duke u hequr si pronar i saj, si dhe mospërdorimi asnjë ditë nga ana e blerësit përforcon faktin se pronar *de facto* i kësaj pasurie është subjekti i rivlerësimit. Kjo në raport dhe vlerësim dhe me faktet, provat dhe rrethanat e tjera të trajtuara më poshtë duke përfshirë edhe faktin e mospërfitimit të ndonjë të ardhure të mundshme nga qiraja dhe as ndonjë fitim nga cedimi i pasurisë nga personi tjetër i lidhur.

Personalisht nuk e vlerësoj bindëse përgjigjen e subjektit se lidhja e posaçme familjare, fatkeqësia familjare e subjektit në vitin 2006, si dhe huadhënia e pashlyer ende në shumën 40,000 euro të jenë arsye e përfitimit në vitin 2004 dhe gëzimin e kësaj pasurie pa kundërshpërblim për 12 vjet.

ii. Në lidhje me mundësinë financiare të familjes H (personi tjetër i lidhur), për likuidimin në vitin 2003 të çmimit të blerjes së kësaj pasurie

Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve shtesë të hetimit, ndër të tjera, subjekti ka paraqitur dy vërtetime të shoqërive të sigurimit “****” ***. dhe “****”¹ ***, me anë të të cilave konfirmohet se krahas pagës, shtetasi T.H ka përfituar komisione dhe/apo bonuse shtesë, si rezultat i punës së kryer prej tij në këto kompani.

Pavarësisht paraqitjes se vërtetimeve nga këto dy shoqëri, nuk provohet marrja e këtyre të ardhurave dhe as pagesa e detyrimeve tatimore përkatëse. Si të tilla, këto të ardhura të pretenduara nga komisionet/bonuset nga ana e z. T. H. nuk mund të konsiderohen si të ardhura të ligjshme që shërbejnë si burim për blerjen e apartamentit në vitin 2003 (pika 3, neni D i Kushtetutës dhe pika 19 e nenit 3 të ligjit nr. 84/2016).

Si burim tjetër të ardhurash, të cilat kanë shërbyer për blerjen nga familja H të apartamentit të ndodhur në rrugën “****”, Tiranë, subjekti ka deklaruar se kanë shërbyer edhe të ardhurat e përfituara prej tyre, si rezultat i shitjes së dy pasurive të paluajtshme të ndodhura në qytetin e Kukësit. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje rezulton se: (a) me anë të kontratës së shitjes² së datës 5.8.2002, shtetasi T.H, nëna dhe bashkëshortja e tij kanë shitur pasurinë e llojit “apartament banimi” të ndodhur në qytetin e Kukësit, me sip. 85 m², për çmimin 1 milion lekë; (b) me anë të kontratës së shitjes³ së datës 4.12.2003, shtetasi T.H ka shitur pasurinë e llojit “banesë njëkatëshe” me sip. 96 m² dhe truallin me sip. 240 m², për çmimin 1 milion lekë.

Por për këto pasuri të shitura subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se vlera reale e shitjes së apartamentit me sip. 85 m² ka qenë rreth 2.5 milionë lekë, ndërsa vlera reale e shitjes së banesës me sip. 96 m² dhe truallit 240 m² ka qenë në shumën 2.8 milionë lekë.

Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti ka depozituar si prova, dokumentet si vijon: (a) raport vlerësimi, datë 2.3.2023, për apartamentin me sip. 85 m², për

¹ Vërtetimi nr. *** prot., datë 1.3.2023, i shoqërisë “****” ***, dhe vërtetimi nr. *** prot., datë 8.2.2023, i shoqërisë “****” ***.

² Kontratë shitjeje apartamenti nr. ***, datë 5.8.2002.

³ Kontratë shitblerjeje për pasurinë e paluajtshme nr. ***, datë 4.12.2003.

vlerësimin e tij në vitin e shitjes 2002; (b) raport vlerësimi, datë 2.3.2023, për banesën me sip. 96 m² dhe truallin me sip. 240 m², për vlerësimin e tyre në vitin e shitjes 2003⁴; (c) shkresë datë 28.2.2023 nga Entit Kombëtar i Banesave⁵; (ç) deklaratë noteriale e shtetasve T.H dhe S.D⁶.

Nga ana e shumicës së trupit gjykues është pranuar pretendimi i subjektit duke përfshirë në analizë financiare të ardhurat e supozuara nga shitja e këtyre dy pasurive të paluajtshme dhe jo të ardhurat e përcaktuara në kontratën e shitjes para noterit për këto pasuri, duke shkuar në kundërshtim me praktikën e ndjekur në procesin e rivlerësimit për subjektet e tjera.

Raporti i vlerësimit i bërë për këto pasuri të shitura nga shtetasi T.H (raport i cili vlerëson pasuritë bazuar në sipërfaqet e tyre dhe çmimet e pasurive në tregun e lirë sipas EKB-së) nuk mund të kundërshtojë një akt shkresor që përbën provë të plotë dhe të lidhur para noterit publik me vullnet të lirë dhe pavesuar.

Kontrata e shitblerjes është një dokument zyrtar që vërteton se pasuria është kaluar nga një pronar tek një tjetër kundrejt një kundërshtpërblimi të caktuar dhe kjo nuk mund të ndryshohet nga një ekspertizë e bërë pas rreth 20 vitesh. Bazuar në këto kontrata edhe vlerat e shitblerjes janë paguar dhe detyrimet përkatëse në buxhetin e shtetit dhe jo në vlera të supozuara. Edhe nëse do të merrej në konsideratë fakti se të ardhurat e përfituara nga shitja e këtyre dy pasurive të paluajtshme janë më shumë se vlera e përcaktuar në kontratat e shitblerjes, përsëri këto vlera nuk mund të merren si burim i ligjshëm, pasi për këto të ardhura nuk janë paguar detyrimet përkatëse në buxhetin e shtetit.

Gjithashtu, në vlerësim duhej mbajtur parasysh edhe fakti se personi tjetër i lidhur T.H nuk ka deklaruar apo provuar asnjëherë se me çfarë burimesh i ka krijuar ai dhe familja e tij këto dy pasuri të paluajtshme.

Në analizën financiare nuk është bërë vlerësim i plotë lidhur me të ardhurat e personit tjetër të lidhur, depozitat bankare të krijuar nga ai dhe bashkëshortja, burimet e ligjshme të krijimit dhe pasuritë e blera apo ndërтуara gjatë periudhës përkatëse (në vitin 2003 - 2004, periudhë kur është krijuar edhe pasuria e ceduar te subjekti i rivlerësimit).

Në vlerësimin përfundimtar të provave dhe shpjegimeve të depozituara nga subjekti, arrij në përfundimin se subjekti nuk arriti të provojë aftësinë paguese të personit tjetër të lidhur T.H për pagesën për blerjen e apartamentit në vlerën 50,000 euro në vitin 2003, duke mospërmbytur kështu barrën e provës të lënë nga Komisioni.

iii. Në lidhje më të ardhurat e subjektit dhe personit të lidhur

Në kuadër të analizimit të analizës financiare për mundësinë e subjektit dhe personave të lidhur për blerjen e pasurisë apartament në vitin 2016, një ndër burimet e përfshira në këtë analizë janë edhe kursimet e pretenduara nga shitja e apartamentit në Kukës në vitin 2013. Rezultoi se në datën 25.3.2013, subjekti i rivlerësimit ka shlyer në mënyrë të plotë dhe të parakohshme detyrimin e mbetur ndaj EKB-së Kukës, për blerjen e

⁴ Dokumentet raport vlerësimi i përgatitur dhe punuar nga inxhinierët vlerësues të licencuar, B.B (vlerësues i shkallës së parë, nr. lic. ***) dhe E.S (vlerësuese e shkallës së parë, nr. lic. ***), si edhe ekonomiste, eksperte fiskale – kontabël dhe eksperte vlerësuese e pasurive të paluajtshme, znj. E.M (vlerësuese e shkallës së dytë, nr. lic. ***).

⁵ Shkresa nr. *** prot., datë 28.2.2023, nga EKB-ja.

⁶ Deklaratë noteriale nr. ***, datë 1.3.2023.

apartamentit në Kukës, duke paguar shumën 869,000 lekë. Lidhur me kryerjen e kësaj pagese subjekti ka deklaruar se si burim për shlyerjen e saj kanë shërbyer kursimet e tij të krijuara ndër vite, të deklaruara më parë në ILDKPKI⁷.

Bazuar në vetëdeklarimet e subjektit, duket se në fund të vitit 2012 ai dispononte gjendjen e likuiditeteve *cash* në shumat 2,000,000 lekë dhe 7,800 euro (e konvertuar në total në vlerën 3,027,964 lekë).

Pas shqyrtimit dhe analizimit të shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit me dërgimin e prapësimeve – mbi rezultatet e analizës financiare paraprake, në vlerësim të tyre në vendimin e shumicës janë reflektuar ndryshimet përkatëse, nga ku rezultoi se referuar analizës financiare përfundimtare vitet 2004, 2005, 2006, 2007 dhe 2009 paraqiten me balancë negative fondesh, për një total prej 1,577,274 lekësh⁸. Ndërkohë, kjo balancë negative është më e lartë se kjo vlerë për shkak se subjekti nuk arriti të provojë si burim të ligjshëm huat e pretenduara nga motra dhe kunata e tij në vitin 2005.

Rezultatet negative të evidentuara në vite ndikojnë drejtpërdrejt në mundësinë e shtesës së likuiditeteve *cash* të deklaruara për çdo vit, prandaj vlerësoj dhe gjykoj se subjekti dhe personat e lidhur nuk kishin mundësi të krijojnë këto kursime me burime të ligjshme e, si rrjedhim, nuk kishin burime të ligjshme të mjaftueshme për pagesën e vlerës 869,000 lekë për apartamentin në Kukës, sipas burimit të vetëdekluar nga ana e tij (kursimet e tij të krijuara ndër vite).

Për këtë shkak, as të ardhurat nga shitja e pasurisë apartament në Kukës në vitin 2013, me të cilat janë shtuar kursimet *cash* të këtij viti, nuk mund të konsiderohen si burim i ligjshëm për blerjen e pasurisë apartament në rrugën “****” në Tiranë në vitin 2016.

1.5 Si përfundim, vlerësoj se subjekti i rivlerësimit nuk ka vërtetuar burimin e ligjshëm të krijimit të pasurisë apartament në rrugën “****” në Tiranë në vitin 2016, nisur nga fakti se pjesa më e madhe e kursimeve të deklaruara nga subjekti deri në momentin e blerjes së pasurisë përbënin të ardhurat nga shitja e apartamentit në Kukës në vitin 2013.

2. Aksione në vlerën 1% (depozituar në vlerën 12,500 euro) të vlerës së përgjithshme të aksioneve të shoqërisë “****” ***, dega ***, të vëna në datën 15.12.2005.

2.1 Lidhur me këtë investim subjekti pretendoi se si burim për këtë investim, të bërë pa dijeninë e tij, kanë qenë edhe huat e marra nga motra dhe kunata e tij në vitin 2005.

2.2 Ky investim dhe këto hua nuk janë deklaruar në DPV-të e viteve 2005 dhe 2006. Në DPV-në e vitit 2007 subjekti deklaroi: “*Aksione tek ‘***’, depozituar nga bashkëshortja në dhjetor 2005 – 12,500 euro. Vënë në dijeni në vitin 2007 nga kompania pas vdekjes së bashkëshortes. Një pjesë e vlerës është marrë nga bashkëshortja prej motrës saj*”.

⁷ Referohuni deklaratës së interesave privatë/periodikë vjetorë të vitit 2013, e depozituar nga subjekti në ILDKPKI.

⁸ Referohuni tabelës përmbledhëse të analizës financiare, Aneks 1, pjesë e këtij vendimi, rezultatet e së cilës janë reflektuar në përputhje me analizimin dhe vlerësimin e shpjegimeve dhe provave përfundimtare të depozituara nga subjekti i rivlerësimit me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, të kryer nga Komisioni në këtë vendim, në veçanti në pikën ku trajtohet “Analiza financiare për periudhën 2002 – 2016”.

2.3 Ndërkohë, subjekti ka bërë shtesë deklarimi për DPV-në e vitit 2007, me datë 20.11.2008, në të cilën tek rubrika e detyrimeve deklaroi: *“Detyrim i mbetur ndaj motrës nga huamarrja e marrë nga bashkëshortja F.T, që në vitin 2005, në shumën 1,000,000 lekë, nga e cila pas vdekjes së saj motra më fali 400,000 lekë dhe nga ana ime është shlyer deri tani 200,000 lekë në vitin 2006. Pjesa e mbetur në shumën 400,000 lekë vazhdon të mbetet detyrim pa interes dhe pa afat”*.

2.4 Subjekti nuk e ka deklaruar marrëdhënien e huas në DPV-në e vitit 2006 edhe pse në DPV-në e vitit 2007 deklaroi se i ka shlyer 200,000 lekë motrës për këtë hua. Subjekti nuk ka deklaruar në asnjë DPV shlyerjen e huas motrës së bashkëshortes së ndjerë, shtetases R.M.

2.5 Subjekti ka bërë shtesa në DPV-në e vitit 2007 (me shkrim dore pas dorëzimit të deklaratës periodike në datën 20.11.2008) duke shtuar motrën e tij si huadhënëse.

2.6 Lidhur me burimin e deklaruar nga motra e bashkëshortes së ndjerë, subjekti ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 11.11.2022, në të cilën ajo deklaroi se shumën e dhënë hua motrës së saj në vitin 2005 e ka kursimet e saj familjare e punësuar si mësuese në *** dhe nga punësimi i bashkëshortit si mësues. Nga një vlerësim financiar i bërë lidhur me të ardhurat e deklaruara nuk rezultoi mundësia për dhënien hua të shumës së pretenduar. Ndërkohë, në përgjigje të rezultateve shtesë të hetimit, subjekti deklaroi se pas komunikimit me kunatën, ajo i ka pohuar se burimi kryesor për dhënien e huas kanë qenë dy kreditë e marra prej tyre në dhjetor të vitit 2005 edhe pse një prej tyre është marrë një ditë pas depozitimit të shumës nga bashkëshortja e subjektit për investim. Këto kredi nuk ishin pretenduar nga kunata e subjektit si burim për huan në deklaratën noteriale të vitit 2022, duke ndryshuar deklarin e bërë më parë.

2.7 Si përfundim, për shkak të: (a) mosdeklarimit në kohën dhe mënyrën e duhur të huave të marra nga bashkëshortja nga persona të tjerë; (b) shtesave të mëvonshme në deklarim lidhur me persona dhe vlera monetare të padeklaruara më herët; (c) mosdeklarimit të shlyerjes së këtyre huave në DPV-në e vitit 2006; (ç) mospërputhjes së deklarimit të burimit të huas së pretenduar nga kunata e subjektit në deklaratën noteriale dhe shpjegimit të subjektit në përgjigje të rezultateve shtesë të hetimit; dhe (d) pamjaftueshmërisë financiare të kunatës së subjektit për dhënien e huas motrës së saj të ndjerë – vlerësoj dhe gjykoj se këto hua nuk mund të konsiderohen si burime të ligjshme për investimin e bërë nga bashkëshortja e ndjerë e subjektit në vitin 2005.

2.8 Balanca negative e llogaritur në vendimin e shumicës lidhur me mundësinë financiare të subjektit dhe personave të lidhur për kryerjen e investimit në shoqërinë “***”, në datën 27.12.2005, krijimin e pasurive të tjera, si edhe mbulimin e shpenzimeve të evidentuara nga Komisioni, gjatë këtij viti është në vlerën -527,339 lekë. Vlerësoj se kjo balancë negative është më e lartë duke pasur parasysh se nuk duhen përfshirë në analizën financiare huat e pretenduara nga subjekti si të marra nga bashkëshortja e ndjerë nga motra dhe kunata e tij në vitin 2005, në vlerën totale prej 1,400,000 lekësh.

3. Analiza financiare për vitet 2002 – 2016

3.1 Sa i përket analizës financiare nuk jam dakord me vendimin e shumicës së trupit gjykues lidhur me përfundimin e arritur sa vijon:

“Komisioni i qëndron rezultatit financiar të referuar si më sipër, pra se subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur nuk kanë pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e pasurive, si dhe kryerjen e shpenzimeve të tjera të deklaruara dhe të evidentuara për vitet 2004, 2005, 2006, 2007 dhe 2009, për një total balance negative në shumën -1,577,274 lekë.

Por, duke risjellë në vëmendje se vetë natyra e analizës financiare është e përafërt dhe jo absolute, e cila mund të paraqesë një shkallë të caktuar pasaktësie në elementet që vlerëson, kjo edhe për shkak të rrethanave të relatuara më sipër, si edhe në konsideratë të faktit nga ku rezulton se kjo balancë negative është e shpërndarë në vite dhe duket se nuk ka ndikim thelbësor në krijimin e pasurive të materializuara dhe të deklaruara si gjendje në deklaratën e rivlerësimit kalimtar Vetting, trupi gjykues arrin në përfundimin se ajo nuk është e tillë, për t’u konsideruar si deklaram i pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016”.

3.2 Vlerësimi i analizës financiare të bërë nga shumica është qasje e gabuar. Balanca totale negative është më e lartë se vlera -1,577,274 lekë, për arsye se në këtë analizë nuk duhen përfshirë vlerat e pretenduara të huave nga motra dhe kunata e subjektit në vitin 2005.

3.3 Nga ana tjetër, kjo balancë negative është e përqendruar pikërisht në ato vite kur subjekti deklaroi shtesat më të mëdha në kursimet *cash*, të cilat, sipas tij, kanë shërbyer si burim për blerjen e apartamentit në Kukës. Këto të ardhura *cash*, të pretenduara së bashku me të ardhurat nga shitja e kësaj pasurie, kanë shërbyer për blerjen e apartamentit në Tiranë në vitin 2016. Kjo pasuri apartament, e blerë në vitin 2016, është pasuri e deklaruar në deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting* dhe pamundësia e krijimit të kursimeve (e vërtetuar nga balancat negative ndër vite), sjell pamundësinë e krijimit të kësaj pasurie me burime të ligjshme.

3.4 Për sa më sipër, për shkak se subjekti nuk arriti të rrëzonte barrën e provës të dërguar lidhur me konstatimet e mëposhtme:

- Mospërdorimi i kësaj pasurie asnjë ditë nga blerësi fillestar (personi tjetër i lidhur).
- Përdorimi i kësaj pasurie vetëm nga subjekti dhe familja e tij pa kundërshpërblim, pa ndërprerje, për një periudhë prej rreth 12 vitesh.
- Pamundësia financiare e familjes H (personi tjetër i lidhur) për pagesën e vlerës së kësaj pasurie me burime të ligjshme të mjaftueshme.
- Deklarimet kontradiktore dhe mosdeklarimet lidhur me burimet e krijimit ndër vite dhe pamundësia financiare.
- Blerja e kësaj pasurie nga subjekti në vitin 2016 me çmim të njëjtë sa ai i blerë në vitin 2003.

3.5 Vlerësoj dhe gjykoj se kemi të bëjmë me pasuri të porositur dhe paguar nga subjekti i rivlerësimit, që në momentin e krijimit të saj, me qëllim përdorimin, disponimin dhe gëzimin e plotë nga ana e tij, por se kontrata e porosisë është lidhur në emër të personit tjetër të lidhur T.H. Ky veprim është kryer, në dukje me qëllim shmangien e kontrollit dhe verifikimin e ligjshmërisë së burimeve, të cilat kanë shërbyer për pagesën/pagesat e kryer/a për likuidimin e çmimit të blerjes të saj.

Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, pas administrimit të provave të administruara gjatë procesit të hetimit nga Komisioni, në analizë të fakteve dhe legjislacionit të zbatueshëm, unë si anëtar trupi gjykues arrij në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit Naim Tota ka arritur nivel të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, duke u gjendur në kushtet e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

Referuar gremës “c” të pikës 1 të nenit 58 dhe të pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për këtë subjekt duhet të ishte vendosur masa disiplinore “shkarkim nga detyra”.

Roland ILIA
Anëtar/kundër